

Kapra Buletin tremujor për Projektin e Binjakëzimit „Forcimi i kapacitetit institucional të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në rrugën drejt anëtarësimit të saj në SEBQ“



➤ **Qëllimi i projektit**

Qëllimi kryesor i këtij projekti të binjakëzimit është të mbështesë Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut (BPRMV) në ruajtjen e stabilitetit makroekonomik dhe financiar përmes harmonizimit të rregullave, rregullores, politikave dhe punës me standardet e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe me praktikat më të mira ndërkombëtare. Kjo do të ndihmojë BPRMV-në të përmbushë mandatin e saj në mënyrë më efektive dhe më efekte.

➤ **Përshkrim i projektit**

Projekti i financuar nga Bashkimi Evropian është në sektorin e binjakëzimit: Financa, tregu i brendshëm dhe kriteret ekonomike. Projekti do të zgjasë 15 muaj, nga shtatori i vitit 2019 deri në dhjetor të vitit 2020 dhe kap një shumë prej 600.000,00 eurosh. Konsorciumin e projektit e përbëjnë Banka Qendrore e Gjermanisë, Banka Popullore e Kroacisë, mi rëpo bankat qendrore të Belgjikës, Lituanisë, Portugalisë, Rumanisë dhe Holandës gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm me përfshirjen e ekspertëve të tyre dhe organizimin e vizitave studiu për kolegët e BPRMV-së.

❖ **Çfarë ndodhi midis 15 shtatorit të vitit 2019 dhe 14 dhjetorit të vitit 2019?**

Komponenti 1:

Shërbimet dhe sistemet e pagesave

Në tremujorin e parë u mbajtën dy misione ekspertësh në Bankën Popullore nga ana e ekspertëve të bankave qendrore të Rumanisë dhe Belgjikës, të cilat kishin për qëllim të forcojnë kornizën institucionale të BPRMV-së për licencim dhe mbikëqyrje të institucioneve për pagesa dhe institucioneve për para elektronike, si dhe licencim dhe mbikëqyrje të sistemeve të pagesave. Punonjësit e BPRMV-së, para së gjithash, nga drejtoria për shërbimet e pagesave dhe drejtoria për mbikëqyrje fituan njohuri që pritët të ndihmojnë në implementimin e rregullores nënligjore në fushën e pagesave.

Komponenti 2:

Rregullorja bankare dhe mbikëqyrja

Në kuadër të aktivitetit të projektit të përqendruar në zhvillimin e udhëzimeve të brendshme për vlerësimin e procesit për përcaktimin e likuiditetit të brendshëm të bankave (ILAAP) dhe nivelin e integritetit në procesin e vlerësimit mbikëqyrës (SREP), u mbajt një vizitë studiu në bankën qendrore gjermane në të cilën morën pjesë 8 punonjës nga drejtoria për mbikëqyrje në terren dhe nga jashtë. Ata kishin mundësi të fitojnë përvojë praktike për ILAAP, ICAAP dhe SREP, si dhe për disa specifika nga metodologjia për mbikëqyrje e zbatuar nga banka qendrore gjermane.

Komponenti 3:

Statistika e llogarive financiare

Në kuadër të këtij komponenti, në tremujorin e parë u zhvillua një mision qëllimi i së cilit ishte të japi analiza për burimin e të dhënave, sistemin aktual dhe procedurat e punës për hartimin e llogarive nacionale financiare (bilancet). Ekspertë nga bankat qendrore të Kroacisë dhe Rumanisë ndanë ekspertizën e tyre, duke punuar bashkë me punonjësit e BPRMV-së për të ndihmuar në hartimin e pilot versionit të llogarive financiare vjetore dhe tremujore, plotësisht të harmonizuara me standardet e SEBQ-së.

Komponenti 4:

Njohuritë dhe aftësitë në analizën e politikave

Në tre muajt e parë të projektit u mbajt një mision i përbërë nga ekspertët rumun për forcimin e aftësive kërkimore dhe aftësive për modelim ekonometrik. Pjesa e parë i kushtua prezantimit të tipareve kryesore makroekonomike të ekonomisë maqedonase. Përveç aktiviteteve tjera, u prezantua edhe modeli DSGE i zbatuar në Rumani R.E.M 2.0 (modeli ekonomik rumun 2.0). BPRMV-ja e zgjodhi këtë model për përgatitjen e punimit hulumtues për vlerësim të lidhjeve

ndërmjet ciklit financiar dhe real, duke pasur parasysh rolin udhëheqës të bankës sa i përket përdorimit të teknikave të sofistikuara për zgjidhjen e çështjeve të këtilla, si dhe për shkak të pranisë së sektorit financiar në modelin e zgjedhur.

Konferenca hyrëse

Projekti filloi me mbajtjen e një konference hyrëse më 30 tetor të vitit 2019. Fjalë përshëndetëse mbajtën guvernatorja e BPRMV-së, Anita Angelovska-Bezhoska, udhëheqësi i Njesisë për Çështje Ekonomike, Forcimi Institucional dhe Bashkëpunim Ndërkufitar i Delegacionit të BE-së në vendin tonë, Frenk Janmat, ambasadori i Republikës Federale të Gjermanisë, Tomas Gerberih dhe sekretari i dytë i Ambasadës së Republikës së Kroacisë, Ana Vučić, si dhe përfaqësues të partnerëve të projektit - bankave qendrore të Gjermanisë dhe Kroacisë. Liderët e projektit dhe të komponentëve nga vendet anëtare dhe nga BPRMV-ja i prezantuan qëndrimet e tyre dhe theksuan rëndësinë e çdo aktiviteti nga komponentët, për mënyrën se si ata do të ndihmojnë BPRMV-në të forcojë kapacitetet e saj institucionale në procesin e aderimit të saj drejt SEBQ-së.

Kontakt:

Zyra e Këshilltarit të Përhershëm për
Binjakëzim
twinning.nbrnm@gmail.com



Projekti financuar nga Bashkimi Evropian

Ky publikim është përgatitur me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e BPRMV-së dhe në asnjë mënyrë nuk i reflekton pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

